

Vajza ime ngatërron b dhe d në klasën e parë

Shumica e fëmijëve i ngatërrojnë shkronjat kur fillojnë të mësojnë.

Ngatërimi i shkronjave në fillim të klasës së parë (CP) është një veçori normale e zhvillimit të trurit kur fillojmë të lexojmë. Kjo nuk është detyrimisht një shenjë e disleksisë. Megjithatë, disa fëmijë i ngatërrojnë shkronjat përgjatë një kohe më të gjatë. Kjo ndikon në performancën e tyre në lexim ose në drejtshkrim. Kur të shqetësoheni?

Vështirësitë aktuale të Amandines në shkollë

Mësuesja i alarmoi prindërit sepse Amandine ka konfuzione kur lexon dhe kur shkruan. Në fund të klasës së parë, ajo ngatërron b dhe d. I ndodh gjithashtu të ngatërrojë p me q dhe b me p. Megjithatë, Amandine-s i pëlqen të lexojë: ajo fillon të marrë libra të vegjël dhe t'i deshifrojë ato. Kur i duhet të mësojë listat e fjalëve të drejtshkruara për shkollën, ia del mbanë dhe ka më pak konfuzion. Ajo i ngatërron më shumë tingujt kur shkruan një fjalë të re. Ajo është e kënaqur që shkon në shkollë.

Zhvillimi i përgjithshëm i Amandines

Kur ishte e vogël, ajo nuk ka pasur probleme për të folur. Ajo e zhvilloi të folurin e saj në mënyrë harmonike që prej moshës 12 muajsh.

Aktualisht, ajo i bën mirë ushtrimet e matematikës, por mund t'i ndodhë të shkruajë 3 dhe 5 mbrapsht.

Nëna e saj tregon: "Mbaj mend që edhe motra e saj e madhe ka ngatërruar germat në klasën e parë (CP), por mësuesja nuk na kishte thënë për këtë dhe në fakt, ajo ishte

zhdukur rreth klasës së tretë (CE2). Pra, pyes veten nëse Amandine ka nevojë për një kontroll për të folurin”.

Kur duhet të shqetësohemi?

Shumica e fëmijëve ngatërrojnë shkronjat dhe numrat në fillim të procesit të tyre të të mësuarit. Është një veçori normale e zhvillimit të trurit kur fillojmë të lexojmë.

Amandine ngatërron shkronjat si b dhe d, p dhe q, p dhe b. Por kjo nuk e pengon atë të mësojë të lexojë dhe të shkruajë. Zhvillimi po shkon normalisht. Asaj i pëlqen të lexojë. Me një fjalë, ka një konfuzion të numrave dhe ka të ngjarë që ajo të ketë shkruar mbrapsht emrin e saj kur ishte 3-4 vjeç.

Për momentin, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar dhe konfuzioni në lidhje me shkronjat ose numrat do të zhduket pak nga pak natyrshëm.

Nëse vështirësitë zgjasin në kohë

Disa fëmijë mund të ngatërrojnë shkronjat dhe kjo e prish performancën e tyre në lexim ose në drejtshkrim.

Konfuzionet mund të jenë shenjë e vështirësive në kapjen e tingujve kur ato vazhdojnë përtej CE2 dhe kur vërehen vështirësi në lexim dhe drejtshkrim. Nëse konfuzionet vazhdojnë të qëndrojnë dhe Amandine fillon të jetë e ngadaltë në lexim dhe drejtshkrim, duhet të parashikohet një kontroll për të folurin për të ditur nëse ka nevojë për trajtim.

Kush duhet konsultuar?

Duhet konsultuar mjeku kurues (i familjes), t'i shpjegohet situata dhe ai pa dyshim do të kërkojë të bëhet një *“bilanc për të folurin me rehabilitim nëse është e nevojshme”*.

Më pas, do të duhet të kontaktoni specialistin e të folurit që e zgjidhni ju vetë.

Bilanci i të folurit

Takimi i parë me ortofonistin do të konsistojë në kuptimin e situatës, në njohjen e fëmijës dhe vështirësive të tij. Do të kryhen teste që ndihmojnë për të shpjeguar përse Amandine ngatërron shkronjat. Kur konfuzioni vazhdon për një kohë të gjatë, shpesh kjo është shenjë e vështirësisë në perceptimin e tingujve, gjë që sjell probleme me leximin dhe shkrimin e fjalëve. Nuk është e rrallë që të njëjtët fëmijë të kenë shqiptuar keq disa fjalë kur kanë qenë 4-5 vjeç.

Në pritje të vlerësimit logopedik (orthophonique), çfarë të bëni në shtëpi?

- Është thelbësore që Amandine të ruajë besimin tek vetja. Ne duhet ta sigurojmë atë dhe t'i shpjegojmë se nuk është faji i saj, as i prindërve, as i mësueses së saj. Ajo nuk ka lidhje me këto vështirësi. T'i themi që ne e duam për atë që është dhe jo për rezultatet e saj në shkollë.
- Mund t'i shkruajmë në një fletë 2 shkronjat që ajo ngatërron, duke i treguar asaj një mënyrë për të kujtuar se cila nga shkronjat është b dhe cila është d. Mund t'i tregojmë që një nga shkronjat shqiptohet me gojë mbyllur dhe tjetra me buzë të hapura. Kështu, me vizatimet e buzëve nën secilën prej shkronjave, ajo do të shmange gabimin dhe rrjedhimisht edhe ngatërrimin e tyre.

Praktikimi sjell të mësuarin: sa më shumë të shohë modelin, aq më pak do të gabojë.

- Mund të bëni të njëjtën gjë me numrat thjesht duke propozuar në një fletë një model të numrave që ajo ngatërron. Ajo mund t'i referohet atij sa herë që duhet të shkruajë një 3 ose një 5 për të shmangur gabimin dhe kështu të mësojë përmendësh kuptimin e saktë të numrit.

Shumica e fëmijëve i ngatërrojnë shkronjat kur fillojnë të mësojnë. Në këtë rast, nuk është e nevojshme të konsultoheni me një ortofonist. Nëse nuk ka pasoja në lexim (nuk lexon shumë ngadalë) ose në drejtshkrim (nuk mban mend drejtshkrimin e fjalëve), nuk ka nevojë të konsultoni mjekun. Konfuzionet do të zhduken pak nga pak natyrshëm në shumicën e rasteve. Megjithatë, disa fëmijë ngatërrojnë rregullisht shkronjat dhe kjo ndikon në performancën e tyre në lexim ose në drejtshkrim. Në këtë rast, rekomandohet një konsultë ortofonike.

Në të dyja rastet, është e rëndësishme të evitohet që fëmija të gabojë. Duhet të korrigjohet menjëherë ose të parandalohet gabimi duke i propozuar ndihma që i tregojnë një mënyrë për ta gjetur vetë tingullin e mirë. Duhet evituar që konfuzioni të instalohet.